

STATUT I SHOQËRISË “BM Group” shpk

Sot, me datë 23.11.2023, Ortak I vetem themelues:

Besmir Teqja, i biri i Xhaferr-it shtetas i Republikës së Shqipërisë, lindur me 19.07.1988, në Tiranë, dhe banues në Tiranë, i pajisur me pashaportë me nr. Personal I80719056I _madhor dhe me zotësi të plote për të vepruar, vendosi miratimin e këtij Statuti me termat e mëposhtme:

DISPOZITA TE PERGJITHSHME

Shoqëria Tregtare “BM Group” shpk rregullon pozicionin e saj juridike, marrëdhëniet e themeluesve, të organeve të saj, llojin e Shoqërisë, kohezgjatjen e veprimtarisë së saj, marrëdhëniet me të punësuarit, duke u bazuar në ligjin nr. 9901, të datës 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, dhe dispozitat e tjera të legjislacionit shqiptar në fuqi që rregullojnë marrëdhëniet e Shoqërive Tregtare, si dhe këtë Statut.

Neni 1

Shoqëria gëzon të drejtën si person juridik, që prej datës në të cilën kryhet regjistrimi i saj në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB).

Neni 2

Forma e Shoqërisë

Shoqëria do të ketë formën e Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar.

Kjo shoqëri do të përballojë humbjet e saj deri në vlerën e kapitalit themeltar të saj të paraqitur në këtë Statut.

Neni 3

Emri i Tregtar

Emri i Tregtar i Shoqërisë është “BM Group” sh.p.k. .



Neni 4 Selia

Shoqëria e ka selinë në adresë: Mullet,Nd. 091, Petrelë,Mullet,1034, Tiranë.

Shoqëria me vendim te Asamblese se Ortakeve, mund të ndryshojë selinë e saj, të hapë zyra përfaqësie, degë, të krijojë filiale, si brenda ashtu edhe jashtë Republikës së Shqipërisë.

Neni 5 Objekti i Veprimtarisë

Objekti kryesor i veprimtarise se shoqerise do te jete:

- 1.** Shitja dhe blerja e makinave te perdorura dhe te reja nga brenda edhe jashte vendit, Import-Eksport, servis per automjete, shitje pjesesh kembimi te reja dhe te perdorura, diagnostikim elektronik i automjeteve, konvergjenca dhe sherbime gomisterie, lysterje dhe sherbime karrocierie, dhenie me qira e automjeteve te cdo lloji, ndertime te ndryshme industriale dhe civile, sherbime ndermjetesimi per blerjen e makinave jashte vendit. Shoqeria mund te kryeje cdo aktivitet tjeter te nevojshem apo te dobishem per realizimin e qellimeve te saj.

Objekti i shoqerise mund te plotesohet e modifikohet ne cdo kohe me miratimin ne perputhje me ligjet perkatese. Shoqeria mund te marre pjese ne shoqeri te tjera qe kane objekt te ngjashem me te.

Neni 6 Kohëzgjatja e shoqerise

Shoqeria do te ushtroje aktivitetin e saj, sipas objektit, per nje periudhe 5(pese vjet) e cila fillon nga data e regjistrimit te saj ne regjistrin tregtar,data 23.11.2023 deri 22.11.2028

Afati i permendur ne piken 1 te ketij neni mund zgjatet me vendim te Ortakut te vetem, ne perputhje me rregullat e percaktuara nga ky Statut me perfundimin e periudhes se percaktuar me siper.

Neni 7 Kapitali

Kapitali i shoqërisë do të jetë 100.000 (njëqind mijë) leke, i zoteruar si me poshte:



Nr.	Emri, Mbiemri	% që zotëron	Kuotat që zotëron
1	Besmir Teqja	100%	1

Ky kapital i perket aksionerit te vetem te shoqerise. Kuotat e Kapitalit Themeltar mund t'u transferohen personave te trete qe nuk bejne pjese ne shoqeri, pasi te jete marre miratimi i ortakeve te tjere te shoqerise, duke respektuar te drejten e parablerjes, kur transferimi behet me ane te shitjes.

Kapitali mund te shtohet ose te pakesohet por jo nen vleren nominale 100.000 leke

Neni 8

DREJTIMI I SHOQERISE

Shoqeria do te drejtohet nga administratori i saj **Besmir Teqja**, ortaku i vetem dhe perfaqesuesi ligjor i saj. Ai eshte perfaqesuesi i shoqerise ne mardhenjie me te tretet dhe ka kopetenca te plota ne drejtimin e saj. Cdo kontrate do te kryhet prej tij dhe ne rast mungese nga perfaqesues i paisur me prokure te posacme

Neni 9

Te ardhurat neto te shoqerise i takojne ortakut te vetem

Neni 10

Kompetencat e Asamblesë

Asambleja e Përgjithshme është kompetente për marrjen e vendimeve për shoqërinë në lidhje me çështjet e mëposhtme:

- Të përcaktojë politikat tregtare të shoqërisë;
- Të vendosë për kryerjen e kontroll-revizionit financiar të shoqërisë me eksperte të caktuar prej tij;
- Të vendosë për zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- Të vendosë për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- Të ushtrojë të drejta të tjera që parashikohen në ligjin Nr. 9901 datë 14/04/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”.



Neni 11
Administrimi i shoqërisë

Ortaku I vetem ka te drejte te emeroje nje administrator, financier, likujdator per problemet e shoqerise si dhe te pajtoje persona te tjere si ortakë

- a. Ortaku i vetem Z. Besmir Teqja
- b. Administratori Z. Besmir Teqja

Neni 12
Viti financiar

Viti financiar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne Qendren Kombetare te Regjistrimit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

Është kompetencë e Asamblesë së Përgjithshme të vendosë për krijimin e fondeve nga të ardhurat neto si dhe përdorimin e tyre.

Neni 13
Riorganizmi i shoqërisë bashkimi-ndarja

Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vendimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2012 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare.”

Neni 14
Të ndryshme

Për çështje që nuk parashikohen dhe rregullohen nga ky Statut vlejné dispozitat e ligjit Nr. 9901 datë 14/04/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, pjesa e parë mbi “Dispozitat e Përgjithshme”, pjesa e katërt për “shoqëritë me Përgjegjësi të Kufizuar” si dhe aktet ligjore që rregullojnë këtë veprimtari.

Statuti u hartua në 3 (tre) kopje, me vlerë të njëjtë juridike për t’u administruar në bazë të ligjit, një kopje për tu dorëzuar në Qendrën Kombëtare të Biznesit, dhe dy kopje mbeten në dokumentacionin bazë të shoqërisë.

ORTAKU I VETEM THEMELUES

“BM Group”

Besmir Teqja

